



132
29.01.2026
REPUBLICA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 200/1 Prot

Elbasan më 29 /01/2026

VENDIM

Nr. 1 datë 28 /01/2026.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin DHJETOR 2025

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin DHJETOR 2025, 83 familje me fond 249.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Shërbimeve Sociale
Drejtori Juridik

D.Shuli
A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elsid Zyma

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

Miraturar datë 28.01.2026

Pro 36

Kundër 0

Abstenim 1

Xlor. Prot
200/2.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 132/1 Prot

Elbasan, më 2.2.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.1, datë 28.01.2026 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin DHJETOR 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



133

28.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 199/1 ProtElbasan më 29/01/2026

VENDIM

Nr. 2 datë 28 /01/2026

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin DHJETOR 2025

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **DHJETOR 2025** gjithsej 260 familje me një fond prej 1.206.211 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Shërbimit Social D.Shuli

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Miratuar datë 28.01.2026

Pro

Kundër

Abstenim

Prot. Nr. 133/2.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 133/1 Prot

Elbasan, më 2. 2.2026


Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.2, datë 28.01.2026 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin DHJETOR 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir Bejtja



134
29.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 198/2 prot

Elbasan më 29.01 2026

VENDIM
Nr. 3 datë 28/01/2026

Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i Bashkise

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28/01/2026 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" në pikën 3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike"

VENDOSI

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë si më poshtë:
 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
 2. Familje shumë të varfëra që për shkaqe sociale nuk arrijnë të aplikojnë sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike"
 3. Familje të varfëra me një bashkëshort të larguar (apo në burg) dhe që nuk mund të fillojnë procedurat e divorcit, apo nuk sigurojnë dokumentat perkatës.
 4. Familje me probleme të tjera sociale.
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë: Çertifikate familjare, fotokopje e kartës së identitetit, formulari i paraqitjes mujore, raporti (formulari) i përshkrimit të gjendjes social-ekonomike të familjes nga Administratori Shoqëror, dokument i statusit si punëkërkes i

papunë nga AKPA ,dokument pronësie si dhe dokumente të tjera plotësuese për dosjen e familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë.

- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike"
- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtore i Shërbimeve Sociale
Drejtore i Juridik

D.Shuli
A.Hoxha

Drejtore i Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Pro. 32.

Kunder 0

Abstënim 4.

Nr. Prot 198/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 134/1 Prot

Elbasan, më 2.2.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.3, datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndihmës Ekonomike nga fondi i Bashkisë”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja



135
29.1.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 201/1 Prot

dt. 29.01.2026

VENDIM

Nr. 4 datë 28 /01/2026

**Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për
bllok-ndihmën ekonomike**

KËSHILLIT BASHKIAK

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28 /02/2025 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale , bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 1,2,3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”

VENDOSI

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si më poshtë:
 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit
 2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune, por që nuk përfitojnë pension pleqërie të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit
 4. Familje me shumë fëmijë të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë të njëjta sipas VKM nr 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike “
- III. Masa e ndihmës ekonomike përlogaritet nga Shërbimi Social Shtetëror sipas VKM nr 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”

IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.

V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtor i Shërbimeve Sociale D.Shuli

Drejtori Juridik


A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja


Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetari i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Nr. 201/2 Prot



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

Nr. 135/ Prot

Elbasan, më 2.2.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.4, datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja



136
29.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6396/1 Prot.

Elbasan, më 29.01.2026.

V E N D I M
Nr. 5 Datë: 28.01.2026

“Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjentit me emërtimin Ish-Godina e Partive Politike (kati i tretë), Z.K. 8524, Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ nga Bashkia Elbasan”.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; V.K.M. nr. 416 datë 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajtëshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan”, i ndryshuar, ligji nr.8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, neni 7, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28.01.2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit “Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjentit me emërtimin Ish-Godina e Partive Politike (kati i tretë), Z.K. 8524, Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ nga Bashkia Elbasan”.

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjentit me emërtimin Ish-Godina e Partive Politike (kati i tretë), me sipërfaqe 205.6 m² ndodhur në lagjen “Partizani”, Z.K 8524, Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ, për t’i përdorur si zyra për anëtarët e kësaj organizate e cila ka si veprimtari hartimin, organizimin dhe realizimin e plan-kalendarit të datave historike të LANÇ në territorin e Bashkisë Elbasan, për periudhën 2 (dy) vjeçare nga data 01.01.2026 deri më 31.12.2027 (planimetria bashkëlidhur).
2. Organizata e Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ nuk ka të drejtë të ndryshojë destinacionin e objektit.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Lutfi Lala

SEKRETARI
Elsid Zyma

Konceptoi: G. Kerri  A. Braneshi  A. Pisha 
Drejtoria P.P.S: G. Dyrmyshi
Drejtoria P.Sh.M: S. Mehmeti
Drejtoria J.I: A. Hoxha
Zv/Kryetar: K. Krasnika

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____ / _____ / 2026

Nr. 6396/2 Prot.

02.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 136/1 Prot.

Elbasan më 2.2.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj Nr 5 datë 28.01.2026 “Për dhënien në përdorim (pa kundërshtim) të ambjentit me emërtimin Ish Godina e Partive Politike (kati i tretë), Z.K. 8524, Organizatës së veteranëve dhe pasardhësve të LANÇ” nga Bashkia Elbasan”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Mr BEJTJA





137
29.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 155/L Prot.

Elbasan, më: 29.01.2026.

V E N D I M

Nr. 6 Datë: 28.01.2026

“Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan”

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; V.K.M Nr. 81 datë 30.01.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bradashesh, të Qarkut të Elbasanit”, i ndryshuar; V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar; V.K.B Nr. 49 datë 24.05.2021 “Për një ndryshim në V.K.B nr.145 datë 27.11.2020 “Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28.01.2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Buxhet-Financës, “Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies me qira të ambjentit (dhomë farmaci), në Njësinë Administrative Bradashesh pranë Qendrës Shëndetësore, me sipërfaqe 39.02 m², me tarifë qiraje mujore 300 lekë/m², për periudhën 1 (një) vjeçare nga data 01.01.2026 deri më 31.12.2026, subjektit qiramarrës **Znj. Olta Rama** (për farmaci).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Buxhet-Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Lutfi Lala

SEKRETARI
Elsid Zyma

Konceptoi: G. Kerri

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria F.B.:

Drejtoria P.Sh.M:

Drejtoria J. I:

Zv/Kryetar:

A. Pisha

G.Dyrmyshi

A. Merkja

S. Mehmeti

A. Hoxha

K.Krasnika

A. Braneshi

Miratur me _____ vota

Vota Pro _____

Vota kundër _____


Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë ____/____/2026

PLANVF

ZYR

7



Nr. 155/2 Prot.

02.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 137/ Prot.

Elbasan më 2.2.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj Nr.6 datë 28.01.2026 “Për dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh ” nga Bashkia Elbasan”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 2429/11 Prot.

Elbasan më: 11.02.2026.

KONTRATË QIRAJE

Lidhur sot më datë ____ .02.2026, midis palëve kontraktuese si më poshtë vijon:

Me cilësinë e “Qiradhënësit”: Bashkia Elbasan përfaqësuar nga kryetari **Z. Gledian Llatja**.

Me cilësinë e “Qiramarrësit”: **Znj. Olta Rama** Subjekt Privat Fizik, me NUIS K32531208K.

I-OBJEKTI I KONTRATËS

Kjo kontratë ka si objekt dhënien me qira të ambjentit (dhomë farmaci + depo) me sipërfaqe 39.02 m², në Njësinë Administrative Bradashesh pranë Qendrës Shëndetësore (Planimetria bashkëlidhur), me tarifë mujore qiraje 300 lekë/m² subjektit qiramarrës Znj. Olta Rama për t'a përdorur për farmaci.

II-BAZA LIGJORE

1. Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;
2. Ligjit Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. V.K.M. Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar;
4. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 49 datë 24.05.2021 “Për një ndryshim në V.K.B nr. 145 datë 27.11.2020 “Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009””;
5. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 6 datë 28.01.2026 “Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan”.

III-PAGESA E QIRASË

Pagesa e qirasë prej 11706 lekë/muaj (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë në muaj do të bëhet me bankë në llogarinë e Bashkisë Elbasan, brenda datës 30 të muajit.

Qiramarrësi do të paguajë të gjitha detyrimet e prapambetura qiradhënësit (Bashkia Elbasan).


Mospagesa brenda afateve të caktuara më sipër e ngarkon qiramarrësin me kamat vonesa e cila është 0,2% e qirasë mujore për çdo ditë vonesë të pagesës së qirasë.

IV-TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

1. **“Qiradhënësi”** ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e **“Qiramarrësit”**.
2. **“Qiradhënësi”** është i detyruar të garantojë gëzimin e qetë të ambjentit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrejnë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.
3. **“Qiradhënësi”** ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës dhe njofton me shkrim me afat prej 15-ditëve që nga momenti i konstatimit se **“Qiramarrësi”** nuk është kujdesur për mirëmbajtjen e ambjenteve, nuk ka kryer pagesat e qirasë, nuk ka zbatuar kushtet e kontratës.

V-TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

1. **“Qiramarrësit”** nuk i lejohet të bëjë asnjë adoptim të ambjenteve të marrë me qira që do të konsistonte në ndërhyrje të strukturave ndërtimore të bodrumit pa marrë miratimin nga ana **“Qiradhënësit”** dhe nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë.
2. **“Qiramarrësi”** është i detyruar të riparojë të gjitha dëmtimet e mundshme që mund t'i behen ambjenteve të dhëna me qira si pasojë e keqpërdorimit apo pakujdesisë së tij në të kundërt qiramarrësi është i detyruar të dëmshpërblejë Bashkinë në masën e dëmit të shkaktuar të vlerësuar sipas ekspertëve.
3. **“Qiramarrësi”** ka të drejtë që sipas legjislacionit në fuqi të përdorë, të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për të gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.
4. **“Qiramarrësi”** ka për detyrë që të përdorë ambjentin sipas objektit të kësaj kontrate.
5. **“Qiramarrësit”** nuk i lejohet që pronën e dhënë me qira ta japë me nënqira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.
6. Janë në ngarkim të **“Qiramarrësit”** të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e përditëshme të ambjenteve të marrë me qira. **“Qiramarrësi”** duhet të shlyejë të gjitha detyrimet ndaj subjekteve përkatës në lidhje me konsumin e energjisë elektrike, ujit, etj. Për këtë **“Qiramarrësi”** do të instalojë matësat përkatës dhe do të kontaktojë me subjektet furnizues. Janë në ngarkim të **“Qiramarrësit”** të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.



VI-KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kjo kontratë lidhet me afat 1 (një) vit, efektet financiare fillojnë nga data 01.01.2026 deri më 31.12.2026.

Kësaj kontrate i bashkëngjitet proces-verbali i dorëzimit të ambjentit (dhomë farmaci + depo) nga ana e Bashkisë Elbasan si **“Qiradhënëse”** dhe **“Qiramarrësi”** Znj. Olta Rama.

VII-ZGJIDHJA E KONTRATËS



Bashkia ka të drejtën e zgjidhjes së Kontratës, nëse konstaton se **“Qiramarrësi”** nuk kujdeset për mirëmbajtjen e ambjentit, nuk kryen pagesat e qirasë apo nuk zbaton kushtet e kontratës.

VIII-ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve gjatë regjimit të kontratës së qirasë, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre, në të kundërt kompetence për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata kompetente.

Kjo kontratë hartohet në 6 (gjashtë) kopje origjinale ku katër kopje i mban **“Qiradhënësi”**, Bashkia (Arkivë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Pronave Publike, Këshilli Bashkiak), një kopje e merr **“Qiramarrësi”** dhe një kopje dërgohet në Degën e Shoqërive Publike pranë Prefekturës.

“Qiramarrësi”
Olta Rama



“Qiradhënësi”
KRYETARI
Gledian Llatja
Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

PROÇES - VERBAL

“Mbi dorëzimin e ambjentit (dhomë farmaci) dhënë me qira në
Nj.A.Bradashesh pranë Qendrës Shëndetësore.”

I mbajtur sot më datë ____02.2026 ndërmjet komisionit të Bashkisë Elbasan për dorëzimin e ambjentit të dhënë me qira në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 6 datë 28.01.2026 “Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj. A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan” dhe subjektit Znj. Olta Rama që merr në dorëzim ambjentin.

Ambjenti që dorëzohet ka të dhëna sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Lloji i Ambjentit	Sipërfaqja m ²	Adresa	Shënime
1.	Dhomë farmaci + depo	39.02	Qendra Shëndetësore Nj.A. Bradashesh	Gjendje të mirë

Në rastin kur qiramarrësi kërkon të bëjë investime që i shërbejnë aktivitetit dhe punës së tij si në restaurime, në përmirësimin e pamjeve të brendshme dhe të jashtme pa ndërhyrje në konstruksion të godinës, atëherë këto i lejohen të bëhen vetëm me leje e miratim të Bashkisë Elbasan. Këto investime nuk njihen nga ana e “Qiradhënësit” (Bashkia Elbasan).

Ky proces verbal mbahet në 6 (gjashtë) kopje të cilat i bashkëngjiten kontratave të qirasë.

Dorëzuesit :

1. Albana Pisha (Spec. D. Pronave Publike dhe Strehimit)
2. Alma Braneshi (Spec. D. Pronave Publike dhe Strehimit)
3. Erion Zejnelhoxha (Spec. D. Buxhet- Financë)

**Marrësi në Dorëzim
Olta Rama**


FARMACI
OLTA RAMA
NIPU M435272020
C. D. S. A. R.

PLANVENDOS

ZYRAVE TE

Zj.OLTA R

ZK.125'



P'



137
28.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 155/1 Prot.

Elbasan, më: 29.01.2026.

V E N D I M

Nr. 6 Datë: 28.01.2026

"Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan"

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"; V.K.M Nr. 81 datë 30.01.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bradashesh, të Qarkut të Elbasanit", i ndryshuar; V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", i ndryshuar; V.K.B Nr. 49 datë 24.05.2021 "Për një ndryshim në V.K.B nr.145 datë 27.11.2020 "Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009", Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28.01.2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Buxhet-Financës, "Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies me qira të ambjentit (dhomë farmaci), në Njësinë Administrative Bradashesh pranë Qendrës Shëndetësore, me sipërfaqe 39.02 m², me tarifë qiraje mujore 300 lekë/m², për periudhën 1 (një) vjeçare nga data **01.01.2026 deri më 31.12.2026**, subjektit qiramarrës **Znj. Olta Rama** (për farmaci).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Buxhet-Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Lutfi Lala

SEKRETARI
Elsid Zyma

Nr. 155/2 Prot.



09.02.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 137/ Prot.

Elbasan më 2.2.2026


Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj Nr.6 datë 28.01.2026 "Për dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh " nga Bashkia Elbasan", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 154/1 Prot.

Elbasan, më: 29.01.2026.

V E N D I M

Nr. 7 Datë: 28.01.2026.

“Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Ndërtimi i rrugës rrotonda e varrezave - intersektimi i rrugës “Nos Josifi”, ndodhur në Z.K 8522 dhe 8527”, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”.

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28.01.2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike:

V E N D O S I :

1. Miratimin në parim për fillimin e procedurës së shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga realizimi projektit me interes publik “Ndërtimi i rrugës rrotonda e varrezave - intersektimi i rrugës “Nos Josifi”, ndodhur në Z.K 8522 dhe 8527”. (planvendosje bashkëlidhur).
2. Miratimin e burimit të financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur, i cili do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e procedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Lutfi Lala

SEKRETARI

Elsid Zyma

Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria F.B.:

Drejtoria P.U: E. Mihali

Drejtoria D.P.P.D.U:

Drejtoria P.Sh.M:

Drejtoria J. I:

Zv/Kryetar:

A. Pisha

G. Dyrmyshi

A. Merkja

M. Avllazagaj

K. Haxhihyseni

S. Mehmeti

A. Hoxha

K. Krasnika

G. Kerri

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____ / _____ / 2026

RRUGA RROTONDA VARREZAVE -INTERSEKTIMI I RRUGES NOS JOSIFI
LAGJIA EMIN MATRAXHIU ,ELBASAN .ZK 8527,8522 INDEX HARTE EL;N-10,11

Shkalla 1:2000



SHENIME TEKNIKE	
1. KY PROJEKT ESHTË PRONË E BASHKISË ELBASAN.	
2. NUK LEJOHET KOPJIMI APO RIPRODHIMI I KETIJ VIZATIMI PA AUTORIZIMIN E DRETORISË SE PROJEKTIMIT DHE SHERBIMEVE INXHINIERIKE NE BASHKINE ELBASAN.	
3. TE RESPEKTOHEN DIMENSIONET E SHKRUAR NE VIZATIM.	
4.PER CDO PAQARTESI APO MOSPERPUTHJE TE PROJEKTIT ME SITUATEN NE TERREN TE MERRET KONTAKT ME PROJEKTUESIN	
5.NUK LEJOHET ASNJE NDRYSHIM I PROJEKTIT PA MIRATIMIN SPECIFIK TE D.P.SH.I –se.	
6.PER PERCAKTIMIN E NGJYRAVE, MATERIALEVE APO MALLRAVE QE DO TE PERDOREN NE KETE PROJEKT DUHET TE MERRET FILLIMISH TE MERRET MIRATIMI I PROJEKTUESIT DHE SUPERVIZORIT.	
ADRESA ELBASAN	

RISHI: PERSHKRIMI :	NGA: DATA:
FAZA E PROJEKTIT : PROJEKTI ZBATIMIT (ARKITEKTONIK)	
 BASHKIA ELBASAN Rruga "Gjeneral Stafa" Lagja "Brig 17 Shtetëse" +35554400152 email: bashkia@elbasan.gov.al web: www.elbasan.gov.al	

INVESTITOR:	
BASHKIA ELBASAN	
DREJTORIA PROJEKTIMIT	
Drejtore ark/Marvis Avllazagaj	
MATJET TOPOGRAFIKE:	
Sektor i Azhronimit Topografik	
Ing. Elton Mihal	
Ing.Fatjona Boja	
PROJEKTI: Rruga "Rotonda Varrezave me Intersektimin e rruges Nos Josifi"	
EMERTIMI I FLETES:	
PLANVENDOSJE	
SHKALLA A3:	DATA: / / 2025
PROJEKTI NR:	FLETA NR:
A3 / 5	

154/2
02.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 138/prot.


Elbasan, më 2.2 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.7 datë 28.01.2026 “Për miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Ndërtimi i rrugës rrotonda e varrezave – intersektimi i rrugës “Nos Josifi”, ndodhur në ZK 8522 dhe 8527”, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI





REPubLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 153/L Prot.

Elbasan, më: 29.01.2026.

V E N D I M

Nr. 8 Datë: 28.01.2026

“Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (bodrum), lagjja “Kongresi Elbasanit” nga Bashkia Elbasan”

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”; i ndryshuar, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar, V.K.B Nr. 49 datë 24.05.2021 “Për një ndryshim në V.K.B nr.145 datë 27.11.2020 “Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28.01.2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Buxhet-Financës, “Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (bodrum), lagjja “Kongresi Elbasanit”, nga Bashkia Elbasan”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies me qira të ambjentit (bodrum), në Pallatin Nr.15/1, Lagjja “Kongresi Elbasanit”, me sipërfaqe 73.16 m², me tarifë qiraje mujore 200 lekë/m², për periudhën 1 (një) vjeçare nga data **01.01.2026 deri më 31.12.2026**, subjektit qiramarrës **Zj. Edlira Zhupa** (për magazinë).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Buxhet-Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Lutfi Lala

SEKRETARI
Elsid Zyma

Konceptoi: G. Kerri
Drejtoria P.P.S.:
Drejtoria F.B.:
Drejtoria P.Sh.M.:
Drejtoria J. I.:
Zv/Kryetar:

[Signature] A. Pisha
[Signature] G.Dyrmyshli
[Signature] A. Merkja
[Signature] S. Mehmeti
[Signature] A. Hoxha
[Signature] K.Krasnika

A. Braneshi

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë ____/____/2026

PLANIMETRI' INDEKSI I ' DHENF

Prone r
te r

Nr. 153/2 Prot

02.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 139/ Prot.

Elbasan më 2. 2. 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj Nr.8 datë 28.01.2026 "Për dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (bodrum), lagja "Kongresi Elbasanit" nga Bashkia Elbasan", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 160/1 Prot.

Elbasan, më: 29.01.2026.

V E N D I M

Nr. 9 Datë: 28.01.2026

“Mbi dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit, ish menca e Konviktit të Shkollës së Muzikës “ONUFRË”, nga Bashkia Elbasan”

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28.01.2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit “Mbi dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit, ish menca e Konviktit të Shkollës së Muzikës “ONUFRË”, nga Bashkia Elbasan”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies në përdorim (pa pagesë) të ambjentit me sipërfaqe totale 253.2 m², ndodhur në Shkollën e Muzikës “ONUFRË” (godina e ish mencës së konviktit), në Lagjen “Brigada 17 Sulmuese”, Fondacionit “Aid To The Balkans”, për periudhën 1 (një) vjeçare nga data 01.01.2026 deri më 31.12.2026, për të kryer aktivitete humanitare të përkujdesit komunitar të shtresave vulnerabël në Rajonin e Elbasanit.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit.
3. Ky vendim hyj në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Lutfi Lala

SEKRETARI
Elsid Zyma

Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria P.Sh.M:

Drejtoria J.I:

Zv/Kryetar:

A. Pisha

G. Dymysht

S. Mehmeti

A. Hoxha

K. Krasnika

G. Kerri

Miraturar me. _____ vota

Vota Pro _____

Vota kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë ____/____/2026

PLANVENDOSJA DHE PLANIMETRIA E A'
Z.K. 8522, NR.PASURISE:44/2
SIPERFAQA E AMBJENTIT :S=25.9

Prone e Bashkise Elbr
te pronave te palur
te qarkut te Elbr

160/2
05.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 140/1 Prot.

Elbasan më 5.2. 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.9, datë 28.01.2026, “Mbi dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambientit, ish-menca e Konviktit të Shkollës së Muzikës ‘ONUFRI’, nga Bashkia Elbasan” konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI
Ilir BEJTJA



141
29.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 151/1 Prot

Dt. 29.01.2026

VENDIM

Nr. 10 datë: 28.01.2026

**PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHITJES TË MATERIALIT DRUSOR, DRU ZJARRI
PËR NEVOJAT E BANORËVE DHE ENTEVE TË BASHKISË ELBASAN**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 54; Ligjin nr. 5/2016 "Për shpalljen e Moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë"; VKM nr.438, datë 08/06/2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore" të ndryshuar; Udhëzimi Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.2, datë 03.03.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajttime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje" Kreu I, dispozita të përgjithshme pika 14; Kontratat e përfunduara me objekt "Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri" të lidhura midis operatorëve ekonomik dhe Bashkisë Elbasan.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Të miratojë tarifën e shitjes së materialit drusor, dru zjarri, në fushën e përcaktuar nga Bashkia Elbasan në vlerën 4175 (katër mijë e njëqind e shtatëdhjet e pesë) lekë/mst.
2. Për teprica që do të rezultojnë nga mos shitja, do të trajtohen sipas V.K.M nr. 614, datë 23.10.2025, kreu III, neni 8, pika 2.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Konceptoi: Q. Poka

Pranoi: J. Bodurri

Miratoi: E. Hazizolli

KRYETARI

Lutfi Lala

Miratuar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____/____ 2026

151/2

05.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 141/1 prot.

Elbasan, më 5.2.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.10 datë 28.01.2026 “Për miratimin e tarifës së shitjes të materialit drusor, dru zjarri për nevojat e banorëve dhe enteve të Bashkisë Elbasan” konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



VENDIM

Nr. 11. Dato - 28.01.2026

Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për Automjete motorrike në administrim të ASHPU"

Bazuar në:

1. Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",neni 54
2. Ligjin nr.10296,datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"
3. Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"

VENDOSI:

1. Të miratojë normativat e konsumit të karburantit per vitin 2026 sipas tabelës bashkëngjitur
- 2.Ngarkohet Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konceptoi:S.Finance Blerina Kotorri

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Elsid Zyma



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



159/2
06.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 142 / Prot.

Elbasan më 06.2. 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj Nr.11 datë 28.01.2026 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për automjete motorrike në administrim të ASHPU”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI
Ilir BEJTJA



143

29.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN PROJEKTEVE DHE DONATORËVE

Nr. 197/1 Prot.

Elbasan, më 29.01.2026

VENDIM

Nr. 12, datë 28/01/2026

PËR

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJEVE TË BASHKEPUNIMIT PËR PROJEKTIN:
“TRANSFORMIMI LIGJOR DHE RREGULLATOR PËR EFIÇENCË TË PËRMIRËSUAR
TË ENERGJISË”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 28/01/2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

VENDOSI

1. Të miratojë: Marrëveshjen e projektit “Transformimi Ligjor dhe Rregullator për Efiçencë të Përmirësuar të Energjisë” dhe partneritetin mes palëve.
2. Ngarkohen për zbatim drejtoritë e Bashkisë Elbasan si: Drejtoria e Integrimit Evropian, Projekteve dhe Donatorëve, Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Transportit, Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit Rinisë, Sportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi: P.S.P.D

K.Kreka

S.S.P.D

D.Qelemeni

Pranoi:

D.D.I.E.P.I

E.Çuni

D.B.F

A. Merkja

D.I.J


A.Hoxha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



197/2
06.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK


Nr. 143/1 Prot.

Elbasan më 6.2. 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.12, datë 28.01.2026, ‘ Për miratimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për projektin: “Transformimi ligjor dhe rregullator për efikasitet të përmirësuar të energjisë” ’ konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI
Ilir BEJTJA



144
29.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 239/1 Prot.

Elbasan, më 29.01.2026

VENDIM

Nr. 13 datë 28.01.2026

“Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2026”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës 28.01.2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh i Bashkisë Elbasan “Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2026”, mbështetur në:

- a) Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- b) Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin” (i ndryshuar);
- c) Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Të miratojë ekipet sportive dhe trajnerët përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2026, si mëposhtë:


Nr.	Disiplinat Sportive / Ekipet	Trajneri	Nr. i sportistëve
	VOLEJBOLL		25
1	Të Rritur	1	13
2	Shpresat (M)	1	-
3	Të Rinj	1	-
4	Të Rritura	1	12
5	Shpresat (F)	1	-
6	Të Reja	1	-
	BASKETBOLL		25
7	Të Rritur	1	13
8	Shpresat (M)	1	-
9	Të Rinj	1	-
10	Të Rritura	1	12

11	Të Reja	1	-
	HENDBOLL		7
12	Të Rritur (M)	1	7
13	Të Rritura (F)	1	-
	KARATE		14
14	Të Rritur	1	6
15	Të Rinj	1	4
16	Të Rritura / Të Reja	1	4
	PESHËNGRITJE		14
17	Të Rritur	1	6
18	Të Rinj	1	4
19	Të Rritura / Të Reja	1	4
	ALPINIZËM		5
20	Të Rritur (M & F)	1	5
	ÇIKLIZËM		7
21	Të Rritur	1	5
22	Të Rinj	1	2
	PING - PONG		9
23	Meshkuj	1	5
24	Femra	1	4
	ATLETIKË		8
25	Të Rritur	1	2
26	Të Rinj	1	2
27	Të Rritura	1	2
28	Të Reja	1	2
	QITJE		4
29	Meshkuj	1	3
30	Femra	1	1
	JUDO		3
31	Meshkuj	1	3
	RADIOAMATORIZËM		2
32	Meshkuj & Femra	1	2
	BOKS		3
33	Meshkuj	1	3


	NOT		3
34	Meshkuj & Femra	1	3
	HARK		
35	Meshkuj	1	-
	MUNDJE		
36	Meshkuj	1	-
	SHAH		
37	Meshkuj	-	-
	RAFTING		
38	Meshkuj	-	-

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe e Sportit, Klubi Shumësportesh, Drejtoria e Buxhet - Financës në Bashkinë Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Elsid Zyma



KRYETARI
Lutfi Lala



Konceptoi:

Drejtori i Klubit Shumësportesh:

M. Backa

Jurist i DASHM të KS:

E. Koka

Pranoi:

Drejtori i Përgjithshëm i Kulturës dhe Sportit: A. Kovaçi

Drejtori Juridik dhe Informacionit:

A. Hoxha

Miratoi:

Drejtori i Përgjithshëm i ShOABF:

S. Mehmeti

Konfirmoi:

Zv/kryetari:

A. Shehu

239/2

05.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE
FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 144/prot.

Elbasan, më 5.2.2026

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr. 13 datë 28.01.2026 "Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumëpalësh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2026", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



145
29.01.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 298/1 prot.

Elbasan, më 29.01.2026

VENDIM

Nr. 14, datë 28.01.2026

PËR MIRATIMIN E "KODIT TË SJELLJES" TË ADMINISTRATËS SË

BASHKISË ELBASAN

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 28.01.2026, pasi u njoh me relacionin përkatës të paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Statistikave dhe Performancës, dhe pasi shqyrtoi propozimet për përmirësimin e "Kodit të Sjelljes", mbështetur në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar
- Ligjin nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",
- VKM nr. 873/2021 "Për miratimin e rregullave të etikës në administratën shtetërore",
 - Udhëzimin e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr. ___, datë ___/2025,

VENDOSI:

- 1- Të shfuqizohet Kodi i mëparshëm i Sjelljes, i miratuar me Vendimin nr. 105, datë 03.09.2025, të Këshillit Bashkiak Elbasan.
- 2- Miratohet "Kodi i Sjelljes" i administratës së Bashkisë Elbasan, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse e tij.
- 3- Ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Koordinator i Integritetit dhe administrata e Bashkisë për:
 - Zbatimin e Kodit sipas dispozitave të tij;
 - Publikimin e Kodit në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në sportelet e informacionit;
 - Organizimin e trajnimeve periodike për të gjithë punonjësit e Bashkisë dhe njërive vartëse mbi përmbajtjen dhe zbatimin e Kodit;


- Sigurimin e nënshkrimit të "Deklaratës së njohjes së Kodit" nga çdo punonjës dhe arkivimin e saj në dosjen personale;

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DPBPMSP L.Haxhiymeri
Drejt.Pergj. Sh.Çullhaj
Drejt Juridike A.Hoxha
Drejt B.Njerz L.Dervish


Sekretari

Elsid ZYMA



Kryetari

Lutfi LALA



298/1
08.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 145 / Prot.
1

Elbasan më 29 . 2 . 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.14, datë 28.01.2026, “Për miratimin e Kodit të Sjelljes të Administratës së Bashkisë Elbasan” konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

Nv. 311/1 Prot

Dt. 29.01.2026

VENDIM

Nr. 15 Datë 28.01.2026

Për miratimin e përdorimit të fondit të Emergjences Civile për vitin 2026, " Për kryerjen e investimeve parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese " , ne Njesite Administrative Tregan, Gjergjan Shushice , Shirgjan dhe Labinot Fushe , per riparimin e demeve te shkaktuar shirat masive te rena ne datat (3 - 8) Janar 2026.

Në mbështetje të: ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 65 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", nenit 30 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", " Për miratimin e përdorimit të fondit të Emergjences Civile për vitin 2026 , për kryerjen e investimeve parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese ne Njesite Administrative Tregan, Gjergjan Shushice , Shirgjan dhe Labinot Fushe , per riparimin e demeve te shkaktuar shirat masive te rena ne datat (3 - 8) Janar 2026 " , VKB Nr. 154 datë 24.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2026", si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

VENDOSI

1. Përdorimin e fondit të Emergjences civile per vitin 2026 per shumen 5.350.000 (pese milion e treqinde e pesedhjetë mijë) lekë , " Për kryerjen e investimeve parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese " , ne Njesite Administrative Tregan, Gjergjan , Shushice , Shirgjan dhe Labinot Fushe , per riparimin e demeve te shkaktuar shirat masive te rena ne datat (3 - 8) Janar 2026.



2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile), dhe Agjencia e Sherbimeve Publike Rurale Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elsid Zyma

Lutfi Lala

Konceptoi:

Specialist

A.Baku

Pranoi:

Drejtori MC

N. Sinani

Dr. Fin dhe Buxhet

A. Merkja

Miratoi:

Dr. PPMCMBP

Sh.Çullhaj

Dr. Juridike

A.Hoxha

Konfirmoi:

Zv/ Kryetari

A. Sula

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kunder _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____/____/2026

311/2
02.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 146/ Prot.

Elbasan, më 2.2.2026

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Adresa: Lagjja "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Elbasan

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj, Nr. 15 datë 28.01.2026 "Për miratimin e Fondit të Emergjencave Civile për vitin 2026, për kryerjen e investimeve parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese, në Njësitë Administrative Tregan, Gjergjan, Shushicë, Shirgjan dhe Labinot Fushë, për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga shirat masive të rëna në datat 93-8) Janar 2026", para se të shprehemi mbi ligjshmërinë e aktit tuaj kërkojmë të na dërgoni dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor të nevojshëm për të vërtetuar investimet që do të kryeni.

Dhe konkretisht, dosja kërkojmë të plotësohet me dokumentet e mëposhtme:

1. Urdhrin e Kryetarit të bashkisë për ngritjen e Komisionit Konstatimit të gjendjes së fatkeqësisë.
2. Procesverbalin e konstatimit të gjendjes për çdo rast të fatkeqësisë.
- 3- Urdhrin e Kryetarit të bashkisë për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të dëmeve.
- 4- Procesverbalin e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia e ndodhur.
- 5- Preventivi nga ana ndërtimore, në vlerë (lekë) për çdo rast ku do të bëhet investimi.
- 6- Plan vendosje për çdo rast të fatkeqësisë së ndodhur, ku do të bëhet investimi.
- 7- Proces verbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak.
- 8- Relacioni përmbledhës, duhet të jetë më i plotë dhe më shkoqitës me shpjegime (përshkrime) konkrete rast pas rasti ku do të kryhet investimi.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinalë ose të njehsuar me origjinalin

Deri në dërgimin e dokumentacionit të plotë, akti i juaj mbetet i pakonfirmuar.

PREFEKTI
Hir BEJTJA